



Datë: 04.06.2025

Numër Protokolli: 3821/2025

A.nr.748/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.748/2025, të datës 28.04.2025, të parashtruar nga ankuesi A.L., kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.748/2025, e datës 28.04.2025, e parashtruar nga ankuesi, A.L.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil, A.L.(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 24.04.2025, përmes postës së Kosovës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në Këshill është pranuar më datë 28.04.2025, kundër Njoftimit të datës 04.04.2025, për refuzimin e aplikacionit në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00016697, Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, pozita e punës *Zyrtar për Regjistrimin e Automjeteve* në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve ARC në Podujevë, të shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e parakohshme, **sepse:**

Nga analizimi i provave të lëndës rezulton se Ministria e Punëve të Brendshme, më datë 14.02.2025, ka shpallur konkursin publik me numër reference RN00016697, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht për pozitën “*Zyrtar për Regjistrim e Automjeteve*” me klasë të pozitës

Profesional 2, një (1) vend pune, në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve ARC në Podujevë , i hapur për aplikim nga data 15.02.2025 deri më datën 16.03.2025.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rezulton se në konkursin përkatës të punësimit ka aplikuar edhe ankuesi i cili sipas Njoftimit të datës 04.04.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, i është refuzuar aplikacioni më arsyetimin se nuk ka plotësuar kriterin e përvojës së punës, pasi që ankuesi nuk ka bashkangjitur kopjet e dëshmisë së punësimit (kontratën/vërtetimin) të lëshuar nga institucioni përkatës që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë.

Ankuesi, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke e kundërshtuar njoftimin për refuzimin e aplikacionit, me pretendimin ankimor se gjatë fazës së aplikimit, i njëjti ka bashkangjitur të gjitha dokumentet e kërkuara përfshirë këtu edhe kualifikimin përkatës si dhe përvojën e punës së kërkuar sipas konkursit. Kërkon nga Këshilli që ta aprovoj ankesën si të bazuar.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 39 paragrafi 12 ku përcaktohet se: *12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative*, si dhe nenin 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimiit Në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *17. Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve*. Andaj, referuar këtij përcaktimi ligjor si dhe duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesi më datë 28.04.2025, është e parakohshme, ngase, kandidati për pranim në shërbim civil ka të drejtë të parashtroj ankesë vetëm pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, ndërsa, në rastin konkret ankuesi ka parashtruar ankesë ndaj njoftimit për refuzim të aplikacionit, si veprim procedural në fazën e verifikimit paraprak, kështu që, duke qenë se ankesa është parashtruar ende pa u shpallur njoftimi për rezultatin përfundimtar për procedurën përkatëse të rekrutimit, atëherë, në kuptim të dispozitave të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ankesa A.nr.748/2025 është e parakohshme.

Lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji i Këshillit thekson faktin së hedhja poshtë e ankesës si parakohshme, nuk mohon të drejtën e ankuesit, që të kundërshtoj vendimin për refuzimin e aplikacionit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse.

Theksuar si me lart, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.748/2025

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, A.L.;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.